



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 30 prill 2018
Nr. ref.: AGJ 1225/18

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KO45/18

Parashtrues

**Glauk Konjufca dhe
11 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-060 për Ratifikimin e
Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe
Malit të Zi**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesit e kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Glauk Konjufca, Albin Kurti, Rexhep Selimi, Liburn Aliu, Albulena Haxhiu, Xhelal Sveçla, Arbërie Nagavci, Fitore Pacolli, Shemsi Syla, Ismajl Kurteshi, Valon Ramadani, Salih Zyba (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës), të gjithë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi).

2. Parashtruesit e kërkesës kanë autorizuar Glauk Konjufcën t'i përfaqësojë ata në procedurën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).

Vendimi i kontestuar

3. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e Ligjit nr. 06/L -060 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi (në tekstin e mëtejme: Ligji për Ratifikimin e Demarkacionit), të miratuar nga Kuvendi më 21 mars 2018.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar për Ratifikimin e Demarkacionit, i cili pretendohet se është në kundërshtim me nenet 1 [Përkufizimi i Shtetit], 2 [Sovraniteti], 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare], 125 [Parimet e Përgjithshme], 126 [Forca e Sigurisë së Kosovës], 127 [Këshilli i Sigurisë së Kosovës], 128 [Policia e Kosovës] dhe 129 [Agjencia e Kosovës për Inteligjencë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 5 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 42 [Saktësimi i kërkesës] dhe 43 [Afati] i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 36 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 29 mars 2018, parashtruesit parashtruan kërkesën me dokumente të shumta të bashkëngjitura në Gjykatë.
7. Më 29 mars 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Selvete Gërzhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.
8. Më 29 mars 2018, kërkesa u ishte komunikuar: parashtruesve të kërkesës; Presidentit të Republikës së Kosovës; Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kryetari i Kuvendit); Kryeministrit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kryeministri); dhe Sekretariatit të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Sekretariati).
9. Në Letrën drejtuar Presidentit të Republikës së Kosovës është vërejtur se neni 45 paragrafi 2 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese përcakton që Ligji i kontestuar nuk mund të shpallet deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese për çështjen e ngritur. Kryetarit të Kuvendit iu kërkua që ta mundësonte shpërndarjen e kërkesës të gjithë deputetëve të Kuvendit dhe nëse dikush

kishte komente që t'i dorëzonte ato deri më 6 prill 2018. Kryeministrit gjithashtu iu dha mundësia që të parashtronte komente deri më 6 prill 2018. Sekretariatit të Kuvendit iu kërkua në mënyrë të veçantë që të dorëzojë në Gjykatë të gjitha dokumentet që mund të jenë relevante për rastin.

10. Më 3 prill 2018, Sekretariati i paraqiti Gjykatës dokumentet si në vijim:

a. Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi nr. 06/L-060 të 20 shkurtit 2018;

b. Kërkesën e Kryeministrit (22 shkurt 2018) në Kuvend për të mbajtur seancë të jashtëzakonshme për shqyrtimin e Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi të 20 shkurtit 2018;

c. Raportin e Komisionit FunkSIONAL për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike të 21 shkurtit 2018;

d. Ftesën dhe rendin e ditës për seancën e jashtëzakonshme plenare të Kuvendit të 22 shkurtit 2018;

e. Raporti me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investimeve Strategjike të 21 marsit 2018;

f. Rezolutën e Kuvendit nr. 06-V-090, të 21 marsit 2018 për miratimin e Ligjit nr. 06/L-060 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi;

g. Ligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi nr. 06/L-060.

11. Sekretariati nuk ka komentuar lidhur me pretendimet e ngritura në kërkesë, por shtoi se nëse ka pasur ndonjë koment nga ana e deputetëve, Gjykata do të informohej në kohën e duhur.

12. Më 6 prill 2018, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan një dokument me sqarime shtesë sipas pretendimeve materiale dhe procedurale të ngritura në kërkesën e tyre.

13. Kryeministri ose deputetët e Kuvendit nuk kanë dorëzuar asnjë koment brenda afatit të paraparë.

14. Më 18 prill 2018, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues njëzëri i rekomandoi Gjykatës ta deklarojë kërkesën të pranueshme dhe të vlerësojë meritat e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

15. Më 21 mars 2012, Qeveria miratoi Vendimin për Emërimin e Anëtarëve të Komisionit Shtetëror për Demarkacion dhe Mirëmbajtje të Kufirit Shtetëror nr. 12/67 (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni për Demarkacion).

16. Më 26 mars 2013, Komisioni për Demarkacionin e Kosovës dhe Komisioni për Demarkacionin e Malit të Zi miratuan një Rregullore të Punës së Përbashkët, lidhur me demarkacionin e kufirit shtetëror në mes të Kosovës dhe Malit të Zi.
17. Më 17 korrik 2013, Qeveria miratoi Vendimin nr. 03/14, me të cilin aprovoi Rregulloren e punës së Komisionit për Demarkacion.
18. Më 8 maj 2015, Qeveria miratoi Vendimin nr. 05/28 për vazhdimin e mandatit të anëtarëve të Komisionit për Demarkacion.
19. Më 25 qershor 2015, Kuvendi miratoi Rezolutën nr. 05-R-03 për Demarkacionin e Kufirit në mes të Kosovës dhe Malit të Zi. Me Rezolutë, ndër të tjera, kërkohej që kufiri me Malin e Zi të përcaktohej bazuar në *“linjat administrative të parapara me legjislacionin në fuqi për kufijtë administrativë të RSFJ-së, kufijtë administrativë të territorit të Kosovës të vitit 1974 dhe Kushtetuta aktuale.”* Përveç kësaj, ai kërkoj nga Kryeministri i Republikës së Kosovës që të ndërmarrë veprime që sigurojnë që Komisioni për Demarkacion të vë në dispozicion të gjitha diskutimet dhe propozimet e Komisionit për Demarkacion të Malit të Zi dhe se Qeveria *“t’i raportojë Kuvendit para miratimit [Marrëveshjes] ndërkufitare ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi”*.
20. Më 5 gusht 2015, Qeveria miratoi Vendimin nr. 01/43, me të cilin aprovoi në parim iniciativën për Marrëveshje për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi. Me vendim detyrohej Ministria e Punëve të Jashtme të ndërmarrë veprime për të nënshkruar marrëveshjen në pajtim me Ligjin nr. 04/L-052 për Marrëveshje Ndërkombëtare.
21. Më 20 gusht 2015, Presidenti i Republikës së Kosovës, me kërkesë të Qeverisë, autorizoi Ministrin e Punëve të Jashtme dhe Ministrin e Punëve të Brendshme të ndërmarrin veprime për nënshkrimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.
22. Më 26 gusht 2015, ministrat përkatës të Punëve të Jashtme dhe ministrat e Punëve të Brendshme të të dy vendeve nënshkruan Marrëveshjen për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi. Kjo marrëveshje u hartua në bazë të punës së përbashkët të Komisionit të Demarkacionit të Republikës së Kosovës dhe Komisionit të Demarkacionit të Malit të Zi.
23. Më 22 shtator 2017, pas zgjedhjeve parlamentare të 11 qershorit 2017, Qeveria e re vendosi (Vendimi nr. 01/04) të emërojë anëtarët e rinj të Komisionit të Demarkacionit dhe kështu shkarkoi anëtarët e Komisionit të mëparshëm të Demarkacionit.
24. Më 3 tetor 2017, Qeveria vendosi (Vendimi nr. 01/06), të autorizojë Komisionin e ri të Demarkacionit për të vlerësuar punën e atij të mëparshëm.
25. Më 4 dhjetor 2017, Komisioni i Demarkacionit i paraqiti Qeverisë Raportin për Vlerësimin e Punës së Komisionit të mëparshëm të Demarkacionit, duke vënë në dukje gabimet që pretendohet se janë kryer prej tij.

26. Më 4 dhjetor 2017, Qeveria miratoi (Vendimi nr. 02/17) Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi (në tekstin e mëtejme: Projektligji për Ratifikimin e Demarkacionit), si dhe Raportin e Komisionit të Demarkacionit të përmendur më lart. Në pajtim me këtë vendim, Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit e procedoi Projektligjin për Ratifikimin e Demarkacionit për shqyrtim dhe miratim nga Kuvendi.
27. Më 5 dhjetor 2017, Projektligji për Ratifikimin e Demarkacionit u dorëzua nga Kryetari i Kuvendit tek deputetët e Kuvendit. Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike (në tekstin e mëtejme: Komisioni i Punëve të Jashtme) ishte i ngarkuar për shqyrtimin e Projektligjit për Ratifikimin e Demarkacionit dhe për të paraqitur Raportin me Rekomandime.
28. Më 16 shkurt 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Presidenti i Malit të Zi nënshkruan një Deklaratë të përbashkët. Ajo parashihte që Republika e Kosovës dhe Mali i Zi të krijojnë një Grup të përbashkët punues për përcaktimin e kufirit në pajtim me Projektligjin për Ratifikimin e Demarkacionit, për ta vlerësuar atë dhe për të korrigjuar gabimet e mundshme në disa pjesë të kufirit shtetëror në mes të Kosovës dhe Malit të Zi.
29. Më 20 shkurt 2018, Kryeministri kërkoi që seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të mbahej më 22 shkurt 2018, në orën 11:00 në lidhje me draftin e Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit.
30. Më 21 shkurt 2018, në bazë të kërkesës së Kryeministrit, Kryesia e Kuvendit vendosi që seanca e jashtëzakonshme do të mbahet më 22 shkurt 2018, në orën 11:00. Megjithatë, për shkak të mungesës së kuorumit, seanca ishte shtyrë.
31. Më 27 shkurt 2018, Kryesia e Kuvendit vendosi që vazhdimi i seancës së shtyrë të jashtëzakonshme do të mbahet më 28 shkurt 2018, në orën 10:00. Megjithatë, për shkak të mungesës së kuorumit, seanca ishte shtyrë përsëri.
32. Më 15 mars 2018, Kryesia e Kuvendit vendosi që vazhdimi i seancës së jashtëzakonshme mbi draftin e Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit do të mbahej më 20 mars 2018. Rrjedhimisht, diskutimi filloi në orën 16:00 dhe vazhdoi deri në orën 01:00 të 21 marsit 2018, kur Kuvendi votoi për shtyrjen e votimit mbi Projektligjin për Ratifikimin e Demarkacionit dhe për të vazhduar seancën më 21 mars 2018, në orën 11:00.
33. Më 21 mars 2018, Komisioni i Punëve të Jashtme i rekomandoi Kuvendit ta miratojë draftin e Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit dhe propozoi një Amendament:

“Neni 3 i Projektligjit ndryshohet si në vijim:

Neni 3

1. Pjesë përbërëse e këtij ligji janë:

1.1. Marrëveshja për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, e nënshkruar në Vjenë me datë 26 gusht 2015;

1.2. Deklarata e përbashkët e Presidentit të Republikës së Kosovës Hashim Thaçi dhe Presidentit të Malit të Zi Filip Vujanović nënshkruar më 16.02.2018.

1.3. Të dhënat zyrtare të Komisionit Shtetëror për demarkacionin e Kufirit Shtetëror - për orientim”.

34. Më 21 mars 2018, në orën 11:00, Kuvendi vazhdoi me votimin e draftit të Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit. Megjithatë, ai u ndërpre për shkak të përdorimit të gazit lotsjellës nga një numër i deputetëve të Kuvendit. Më pas, Kryesia e Kuvendit (Vendimet 06/V-112 dhe 06/V-112), largoi nga pjesëmarrja në seancë të jashtëzakonshme një numër të deputetëve të Kuvendit “për shkak të hedhjes së gazit lotsjellës në seancën e 21 marsit 2018”, dhe një deputet i Kuvendit “për shkak të shkatërrimit të pajisjeve të dhomës së seancës plenare”.
35. Më 21 mars 2018, pas disa ndërprerjeve dhe pas ricaktimit pasues të seancës së jashtëzakonshme nga Kryesia e Kuvendit, Kryetari i Kuvendit vazhdoi me miratimin e amendamenteve të propozuara nga Komisioni i Punëve të Jashtme dhe më pas për miratimin e draftit të Ligji për Ratifikimin e Demarkacionit në tërësi. Sipas transkriptove të seancave (22, 23 dhe 28 shkurt 2018 dhe më 20 dhe 21 mars 2018), ishin të pranishëm dhe votuan nëntëdhjetë e një (91) deputetë, tetëdhjetë (80) deputetë votuan për, njëmbëdhjetë (11) deputetë votuan kundër dhe nuk kishte abstenime. Ndryshimi i projektligjit për Ratifikimin e Demarkacionit u miratua në tërësinë e tij.
36. Prandaj, më 21 mars 2018, Kuvendi miratoi Ligjin Nr. 06/L-060 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi (Ligji për Ratifikimin e Demarkacionit).
37. Ligji për Ratifikimin e Demarkacionit e përcakton:

“Neni 1

Ratifikohet Marrëveshja për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, e nënshkruar në Vjenë me datë 26 gusht 2015.

Neni 2

Dispozitat e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, e nënshkruar në Vjenë me datë 26 gusht 2015, nëse ka fakte të reja ligjore, mund të ndryshohen dhe plotësohen me pëlqimin e palëve. Dispozitat e kësaj marrëveshje mund të ndryshohen sipas procedurës së njëjtë të paraparë për miratim. Me pajtimin e palëve, për ndryshimin e dispozitave të marrëveshjes mund të kërkohet edhe Arbitrazh ndërkombëtar.

Neni 3

2. Pjesë përbërëse të këtij ligji janë:

1.1. Marrëveshja për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, e nënshkruar në Vjenë me datë 26 gusht 2015;

1.2. Deklarata e përbashkët e Presidentit të Republikës së Kosovës Hashim Thaçi dhe Presidentit të Malit të Filip Vujanoviç të nënshkruar më 16.02.2018.

1.3. Të dhënat zyrtare të Komisionit Shtetëror për demarkacionin e Kufirit Shtetëror - për orientim.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës”.

Argumentet e paraqitura nga parashtruesit e kërkesës

38. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se procedura e ndjekur për miratim si dhe përmbajtja e Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit, janë në kundërshtim me nenet 1 [Përkufizimi i Shtetit], 2 [Sovraniteti], 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare], 125 [Parimet e Përgjithshme], 126 [Forca e Sigurisë e Kosovës], 127 [Këshilli i Sigurisë i Kosovës], 128 [Policia e Kosovës] dhe 129 [Agjencia e Kosovës për Inteligjencë] të Kushtetutës.

Sa i përket procedurës së ndjekur

39. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se “[K]ërkesa e dorëzuar në Kuvend [nga Kryeministri] për thirrjen e seancës së jashtëzakonshme nuk përmbush kriterin e përcaktuar në nenin 38 par 3 të Rregullores së Punës së Kuvendit”, sipas të cilit parashihet që kërkesa për seancë të jashtëzakonshme duhet të japë arsyetimin se pse një çështje e caktuar konsiderohet “urgjente”. Ata konsiderojnë se dështimi për të dhënë një arsyetim për kërkesën për një seancë të jashtëzakonshme siç kërkohet me nenin 38 (3) i Rregullores së punës së Kuvendit, gjithashtu çon në shkelje të nenit 69 (4) të Kushtetutës, i cili parashihet se Kuvendi mblidhet në seancë të jashtëzakonshme sipas kërkesës, në mes tjerash, të Kryeministrit.
40. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se që nga koha kur është kërkuar dhe caktuar seanca e jashtëzakonshme, deri në miratimin e Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit, ka kaluar më shumë se një (1) muaj. Kështu, çështja që fillimisht konsiderohej urgjente, por nuk u vendos për më shumë se një (1) muaj, nuk korrespondon me natyrën e ‘çështjes urgjente’ siç parashihet në nenin 69 (4) të Kushtetutës, në lidhje me nenin 38 (3) të Rregullores së punës së Kuvendit.
41. Parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se Ligji nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare nuk specifikon në asnjë nga dispozitat e tij se “një marrëveshje ndërkombëtare duhet të ratifikohet (në seancë të jashtëzakonshme) si urgjente”. Kështu, ata konsiderojnë se ratifikimi i një marrëveshjeje ndërkombëtare në seancë të jashtëzakonshme është në kundërshtim me nenin

18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, i cili rregullon ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare.

42. Parashtruesit e kërkesës specifikojnë se gjatë diskutimit të Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit që filloi me 20 mars 2018 në orën 16:00, dhe vazhdoi deri më 21 mars në orën 01:00, ishte propozuar që të vazhdojë më 21 mars në orën 11:00. Ky propozim u vu në votim nga Kryetari i Kuvendit dhe “69 deputetë ishin të pranishëm, 46 votuan ”Për” 1 ishte “Kundër” dhe “Abstenimet” nuk u numëruan”. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se duke mos verifikuar nëse të gjithë deputetët që përbënin kuorumin votuan ”Për”, “Kundër” ose “Abstenim”, çoi në shkelje të nenit 69 (3) [Orari i Seancave dhe Kuorumi] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 51 (3) të Rregullores së punës së Kuvendit, që kërkon që ligjet, vendimet dhe aktet e tjera të Kuvendit konsiderohen si të miratuara nëse votohen nga shumica e deputetëve të pranishëm dhe që votojnë.
43. Parashtruesit e kërkesës konsiderojnë më tej se Vendimi 06/V-114 i Kryesisë së Kuvendit për përjashtimin e një numri të deputetëve nga seanca e jashtëzakonshme e 21 marsit 2018, “për shkak të hedhjes së gazit lotsjellës”, nuk ishte i saktë, sepse shumica e deputetëve të përjashtuar nuk hodhën gaz lotsjellës në seancë. Prandaj, largimi i tyre nga seanca përbën shkelje të “neneve 18 dhe 80 të Kushtetutës në lidhje me nenin 21 të Rregullores së punës së Kuvendit, për shkak se u është mohuar e drejta për ta shprehur vullnetin e tyre të lirë” për çështjen që u diskutua dhe u vendos në seancën e 21 marsit 2018.

Në lidhje me substancën e Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit

44. Parashtruesit e kërkesës specifikojnë se Ligji nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror kërkon që Qeveria të emërojë anëtarë të Komisionit të Demarkacionit dhe Mirëmbajtjes së Kufijve Shtetëror, në bazë të “marrëveshjeve ndërkombëtare”. Sipas parashtruesve, “marrëveshja ndërkombëtare” e përmendur në nenin 40 të këtij Ligji nënkupton “Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës” (në tekstin e mëtejshëm: Pakoja e Ahtisarit). Kështu, ata pretendojnë se i gjithë procesi i demarkacionit të kufirit shtetëror midis Kosovës dhe Malit të Zi duhej të ishte bërë në përputhje me Pakon e Ahtisaarit, i cili kërkonte që vijat kufitare të shënoheshin në përputhje me ato të 31 dhjetorit 1988.
45. Parashtruesit e kërkesës ankohen se Komisioni i Demarkacionit nuk ka ndjekur historinë kushtetuese dhe ligjore të integritetit territorial të Kosovës dhe ka pranuar propozimin e Komisionit të Demarkacionit të Malit të Zi për të përcaktuar vijën kufitare ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi bazuar në kriterin kadastral. Ky kriter është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare e cila nuk i njeh ‘kriteret kadastrale’ si kritere të vetme për demarkacionin e kufirit. Kështu, duke injoruar kriteret e ‘uti possidetis’ dhe ‘kriteret efektive të kontrollit’, kufiri i përcaktuar është pesë (5) deri në gjashtë (6) kilometra brenda territorit të Kosovës.
46. Lidhur me këtë, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Komisioni i ka tejkaluar kompetencat e veta duke kryer caktimin e një kufiri të ri në vend të

kryerjes së demarkacionit të vijës kufitare siç ishte mandatuar me Ligjin për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror. Kështu, Komisioni ka shkelur sovranitetin dhe integritetin territorial të Kosovës, të garantuar me nenin 2, paragrafi 2 [Sovraniteti] i Kushtetutës si dhe nenet 125 [Parimet e Përgjithshme] deri 129 [Agjencia e Kosovës për Inteligjencë] të Kushtetutës, të cilat specifikojnë institucionet kushtetuese të cilat kanë obligime kushtetuese për të mbrojtur kufijtë territorialë të Kosovës.

47. Parashtruesit e kërkesës rikujtojnë Rezolutën e Kuvendit të 25 qershorit 2015 me të cilën kërkohej nga ish-Kryeministri Isa Mustafa që të ndërmarrë masa për të siguruar që Komisioni i Demarkacionit të zbulojë të gjitha diskutimet dhe çështjet e ngritura nga Komisioni i Demarkacionit të Malit të Zi dhe të raportojë para lidhjes së marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi. Ata pretendojnë se Qeveria e Kosovës nuk e respektoi Rezolutën e Kuvendit dhe gjithashtu nuk arriti ta shkarkojë Komisionin e Demarkacionit, edhe pse Qeveria u informua se Komisioni kishte tejkaluar kompetencat e veta.
48. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Raporti i Komisionit të Demarkacionit i 4 dhjetorit 2017, i cili është pjesë e Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit, argumenton se Marrëveshja për Demarkacionin e Kufirit të 26 gushtit 2015 shkel dispozitën kushtetuese të neneve 1 [Përkufizimi i Shtetit], 2 [Sovraniteti], 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 125 [Parimet e Përgjithshme] dhe 129 [Agjencia e Kosovës për Inteligjencë] të Kushtetutës, sepse, në vend të demarkacionit të kufijve ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi, ajo përcaktoi kufij të rinj (caktimi i kufijve)).
49. Kështu, deputetët e Kuvendit të cilët votuan për miratimin e Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit, shkelin sovranitetin dhe integritetin territorial të Kosovës, sepse Ligji që ratifikon Marrëveshjen dhe vetë Marrëveshja duhet të jenë në përputhje me elementët përbërës të sovranitetit shtetëror dhe integritetit territorial. Prandaj, çdo ligj, akt nënligjor ose marrëveshje që shkel sovranitetin dhe integritetin territorial të shtetit duhet të shfuqizohet nga një perspektivë kushtetuese dhe ndërkombëtare.
50. Përveç kësaj, në sqarimin e tyre të 6 prillit 2018, parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë se neni 3 (1 dhe 2) i Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit është kontradiktor, i pakuptueshëm dhe krijon konfuzion. Në lidhje me këtë, parashtruesit specifikojnë se Qeveria *“krijoi qëllimisht konfuzionin, mashtrimin dhe çorientimin e publikut dhe sidomos të deputetëve të Kuvendit, me qëllim që t'i tërheq ata me qëllimin përfundimtar që ata të votojnë”*.

Pranueshmëria e kërkesës

51. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i përmbush kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe siç parashihet më tej me Ligj dhe të përcaktuara në Rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

52. Gjykata i referohet nenit 113 (1) [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton se *“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”*.
53. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 113 (5) të Kushtetutës, i cili përcakton se, *“Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur.”*
54. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se parashtruesit e kontestojnë kushtetutshmërinë e Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit në lidhje me substancën e tij dhe procedurën e ndjekur për miratimin e tij.
55. Gjykata më tej rikujton se kërkesa është dorëzuar nga 12 deputetë të Kuvendit, në pajtim me nenin 113 (5) të Kushtetutës. Prandaj, parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar.
56. Gjykata merr parasysh nenin 42 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh:
“1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 6 të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:
1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;
1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe
1.3. paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet kontesti.”
57. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës treguan emrat me nënshkrimet e deputetëve, specifikuan ligjin që ata kontestuan, iu referuan dispozitave përkatëse kushtetuese që pretendojnë se janë shkelur dhe kanë paraqitur prova që mbështetin pretendimet e tyre. Prandaj, Gjykata konsideron se janë përmbushur kërkesat e nenit 42 të Ligjit.
58. Lidhur me afatin e përcaktuar prej *“tetë (8) ditëve nga data e miratimit”*, Gjykata vëren se Ligji për Ratifikimin e Demarkacionit është miratuar më 21 mars 2018, ndërsa kërkesa është parashtruar në Gjykatë më 29 mars 2018.
59. Gjykata rikujton që në pajtim me rregullin 27 të Rregullores së punës, afati i fundit për dorëzimin e kërkesës, *“kur periudha shprehet me ditë, ajo duhet të llogaritet duke filluar nga dita pasi kishte ndodhur një ngjarje”*. Në këtë rast, kjo është dita e nesërme pas miratimit të Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit. Prandaj, kërkesa është dorëzuar në afatin e duhur.
60. Gjykata konsideron se nuk ka arsye për ta deklaruar këtë kërkesë të papranueshme. Prandaj, kërkesa është e pranueshme.

Analiza krahasimtare

61. Para se të vlerësojë nëse Ligji i kontestuar për Ratifikimin e Demarkacionit është në përputhje me Kushtetutën, Gjykata rikujton se tashmë ka përdorur analiza krahasuese të hollësishme në rastin e saj nr. KO95/13, *Visar Ymeri dhe 11 deputetë të tjerë*, Aktgjykim i 9 shtatorit 2013.
62. Gjykata thekson se Kushtetutat e vendeve të ndryshme evropiane i qasen çështjes së vlerësimit të kushtetutshmërisë së ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare në mënyra të ndryshme. Këto dallime janë rezultat i mënyrave të ndryshme me të cilat definohet marrëdhënia midis një marrëveshjeje ndërkombëtare dhe rendit juridik të vendit. Ky mund të kuptohet se shtrihet përgjatë një spektri të qasjeve kushtetuese.
63. Në njërën anë qëndron qasja e marrë nga Mbretëria e Bashkuar ku marrëveshjet ndërkombëtare lidhen nga Mbretëresha nëpërmjet Ministrit të saj për Punët e Jashtme dhe Komonveltit (*Commonwealth*) dhe nuk është e domosdoshme që të ratifikohen nga Parlamenti Britanik para se të bëhen të obligueshme për shtetin. Pasi njëherë të lidhen, ato e detyrojnë shtetin vetëm sa i përket marrëdhënieve me shtetet e tjera, dhe nuk kanë fuqi në rendin e brendshëm juridik të Mbretërisë së Bashkuar. Në mënyrë që dispozitat e një marrëveshjeje ndërkombëtare të hyjnë në fuqi brenda rendit juridik vendës, duhet të miratohet legjislacioni i veçantë që përmban ato dispozita dhe që përcakton veprimin e tyre brenda rendit juridik vendës. Sapo të inkorporohen nëpërmjet legjislacionit të veçantë, këto dispozita qëndrojnë në një rend juridik më të ulët se Kushtetuta e shtetit.
64. Në anën e kundërt të spektrit, është qasja që ka përqafuar Holanda. Atje, pas ratifikimit nga Parlamenti, marrëveshja ndërkombëtare bëhet e obligueshme për shtetin në marrëdhëniet e tij me vendet e tjera dhe çdo dispozitë e vet-ekzekutueshme e marrëveshjes bëhet e detyrueshme brenda rendit të brendshëm juridik. Për më tepër, dispozitat e marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare janë të një rendi më të lartë juridik, madje, edhe se Kushtetuta e shtetit dhe legjislacioni vendës mund të shqyrtohet nga të gjitha gjykatat përkitazi me pajtueshmërinë e tij me obligimet që dalin nga marrëveshje të tilla ndërkombëtare.
65. Sistemi kushtetues i Kosovës ka specifikat e veta bie në mes të këtyre dy shembujve. Pas ratifikimit nga ana e Kuvendit, një marrëveshje ndërkombëtare bëhet e obligueshme për shtetin në marrëdhëniet e tij me shtetet e tjera dhe marrëveshjet e tilla bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik. Megjithatë, dispozitat e një marrëveshjeje ndërkombëtare, që janë të vet-ekzekutueshme, janë të një rendi më të lartë juridik se legjislacioni i Kosovës, porse qëndrojnë në një rend juridik me të ulët se Kushtetuta e Kosovës, siç përcaktohet me nenin 19 të Kushtetutës. Dispozitat e vet-ekzekutueshme të marrëveshjeve ndërkombëtare mund të zbatohen drejtpërdrejt brenda rendit të brendshëm juridik të Kosovës, por zbatimi i tyre i nënshtrohet Kushtetutës (Shih rastin nr. KO95/13, *Visar Ymeri dhe 11 deputetë të tjerë*, Aktgjykimi i 9 shtatorit 2013, paragrafët 53-69).

Meritat

66. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Ligji për Ratifikimin e Demarkacionit të Kufijve Shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi është në kundërshtim me Kushtetutën, si për nga procedura e ndjekur ashtu edhe për nga substanca e tij.

Sa i përket procedurës së ndjekur për miratimin e ligjit të kontestuar

67. Parashtruesit e kërkesës ankohen se procedura për miratimin e ligjit të kontestuar është në kundërshtim me:
- a. Nenin 69 (4) [Orari i Seancave dhe Kuorumi] i Kushtetutës në lidhje me nenin 38 (3) të Rregullores së punës "*... sipas të cilëve kërkesa për seancë të jashtëzakonshme duhet të japë arsytimin përse çështja e caktuar konsiderohet urgjente*".
 - b. Nenin 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, i cili rregullon çështjen e ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare, sepse "*Ligji nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare nuk specifikon në asnjë prej dispozitave të tij se një marrëveshje ndërkombëtare duhet të ratifikohet (në seancë të jashtëzakonshme) si urgjente*".
 - c. Nenin 69 (3) [Orari dhe Seancat dhe Kuorumi] i Kushtetutës në lidhje me nenin 51 (3) të Rregullores së punës së Kuvendit, i cili përcakton: "*Kuvendi ka kuorum kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e të gjithë deputetëve të Kuvendit*". Këto nene ishin shkelur sepse nuk u verifikua nëse të gjithë deputetët që përbënin kuorumin votuan "Për", "Kundër" ose "Abstenuan". Përveç kësaj, parashtruesit pretendojnë se propozimi i ligjit të kontestuar ishte vënë në votim nga Kryetari i Kuvendit dhe "*69 deputetë ishin të pranishëm, 46 votuan "Për", 1 ishte "Kundër" dhe "Abstenuimet" nuk u numëruan*".
 - d. Nenet 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] dhe 80 [Miratimi i Ligjeve] të Kushtetutës në lidhje me nenin 21 të Rregullores së punës së Kuvendit, sepse: "*atyre (deputetëve) iu mohua e drejta për të shprehur vullnetin e tyre të lirë*". Lidhur me këtë, parashtruesit konsiderojnë më tej se Vendimi 06/V-114 i Kryesisë së Kuvendit për përjashtimin e një numri të deputetëve nga seanca e jashtëzakonshme e 21 marsit 2018, "*për shkak të hedhjes së gazit lotsjellës*" nuk ishte i saktë, sepse shumica e deputetëve të përjashtuar nuk hodhën gaz lotsjellës në seancën e Kuvendit.
68. Megjithatë, Gjykata përsërit se mund të analizojë vetëm hapat e ndërmarrë nga Qeveria dhe Kuvendi për miratimin e ligjit të kontestuar, në bazë të dispozitave përkatëse kushtetuese, përkatësisht procedurës legislative dhe procesit të duhur.
69. Përkitazi me këtë, Gjykata vëren se kompetencat e Kuvendit janë të përcaktuara në nenin 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës, nga të cilët, për rastin aktual, janë relevante vetëm paragrafët e tyre 1 dhe 4. Ata parashohin si më poshtë:

“Kuvendi i Republikës së Kosovës:

(1) miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme;

[...]

(4) ratifikon traktatet ndërkombëtare;”

70. Kuvendi, në bazë të kompetencës së tij sipas nenit 65 (1) të Kushtetutës, votoi dhe miratoi Ligjin për Ratifikimin e Demarkacionit, në përputhje me kërkesat për miratimin e një ligji të parapara në paragrafin 1 të nenit 80 [Miratimi i Ligjeve] që përcakton: *“Ligjet, vendimet dhe aktet tjera miratohen nga Kuvendi me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur është ndryshe e përcaktuar me këtë Kushtetutë”.*

71. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu i referohet nenit 18 (1) të Kushtetutës dhe nenit 10 (2) të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, i cili përcakton procedurën për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Paragrafi 1 i nenit 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] parasheh si në vijim:

“Kuvendi i Republikës së Kosovës me votat e dy të tretave (2/3) e të gjithë deputetëve ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare për këto çështje:

(1) territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake;

(2) të drejtat dhe liritë themelore;

(3) anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare;

(4) marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga ana e Republikës së Kosovës;”

72. Prandaj, ratifikimi i një marrëveshjeje ndërkombëtare për demarkacionin e kufijve të shtetit lidhet me lëndën e territorit të shtetit dhe për këtë arsye del në kuadër të nenit 18 (1) të Kushtetutës. Si e tillë, Marrëveshja për Demarkacion kërkon një shumicë prej dy të tretash në Kuvend për ratifikimin e saj.

73. Sa i përket asaj se cili autoritet i një Shteti ka kompetencë për të lidhur traktatet ndërkombëtare, Gjykata i referohet nenit 2 (c) të Konventës së Vjenës për Ligjin e Traktateve të vitit 1969, i cili përcakton “kompetenca të plota” që nënkupton *“[...] një dokument që del nga autoritetet kompetente të një Shteti ose nga organi kompetent i një organizate ndërkombëtare që përcakton një person apo disa persona për të përfaqësuar shtetin apo organizatën për të negociuar, miratuar apo vërtetuar autenticitetin e tekstit të një marrëveshjeje, për të shprehur pëlqimin e Shtetit apo organizatës për të qenë i detyruar nga dispozitat e një traktati, apo për të përmbushur çdo akt tjetër në lidhje me një traktat”.*

74. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se referencën tek 'autoriteti kompetent' për të lidhur marrëveshje ndërkombëtare, ia lë ligjit të brendshëm të secilit shtet për të përcaktuar autoritetin që mban kompetencat e plota. Zakonisht, këto dokumente dalin nga Kreu i Shtetit (ose dikush tek i cili ka deleguar kompetencat e nevojshme), kreu i qeverisë ose ministri i jashtëm dhe mbajnë simbolin zyrtar dhe, në disa raste, vulën e një vendi.

75. Përveç kësaj, ligji i brendshëm i Kosovës i cili rregullon se cilat institucione janë të autorizuar për të lidhur marrëveshje ndërkombëtare është përcaktuar

në nenin 6 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare që deklarohen si në vijim:

“[...]

1. Presidenti, Kryeministri dhe Ministri i Punëve të Jashtme kanë të drejtën e kryerjes së të gjitha veprimeve të ndërlidhura me lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Konventën e Vjenës për të Drejtën e Traktateve.

2. Shefi i misionit diplomatik të Republikës së Kosovës ose përfaqësuesi i autorizuar i Republikës së Kosovës në një konferencë ndërkombëtare, organizatë ndërkombëtare ose një prej organeve të tyre ka të drejtën e negociimit të lidhjes së marrëveshjes ndërkombëtare të Republikës së Kosovës ose të miratojë tekstin me shtetin në të cilin është akredituar ose në konferencën ndërkombëtare, organizatën ndërkombëtare ose një prej organeve të tyre.

3. Personat tjerë, mund të kryejnë veprime drejt lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës vetëm me kusht që kanë fuqi të deleguara në bazë të ligjit në fuqi dhe procedurës së përcaktuar në nenin 6 të këtij ligji.

[...]”

76. Gjykata vëren se më 25 qershor 2015, Kuvendi miratoi Rezolutën nr. 05-R-03 për Demarkacionin e Kufirit Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi. Përveç kësaj, ai kërkoi nga Kryeministri të ndërmarrë veprime për të siguruar që Komisioni i Demarkacionit t'i vë në dispozicion të gjitha diskutimet dhe propozimet e Komisionit të Demarkacionit të Malit të Zi. Ai gjithashtu kërkoi që Qeveria të raportojë në Kuvend para miratimit të marrëveshjes në mes të Kosovës dhe Malit të Zi.

77. Kështu, filloi një seri veprimesh që përfshinë Kryeministrin, Presidentët përkatës të Kosovës dhe Malit të Zi, ministrat e Punëve të Jashtme dhe të Punëve të Brendshme para se Ligji i kontestuar për Ratifikimin e Demarkacionit, iu paraqit deputetëve të Kuvendit. Më pas, më 21 mars 2018, Kuvendi votoi dhe miratoi Ligjin e kontestuar për Ratifikimin e Demarkacionit.

78. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 10 të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, i cili, përveç që përsërit dispozitën e nenit 18 të Kushtetutës, parasheh:

“

2. Marrëveshjet ndërkombëtare të referuara në paragrafin 1. të këtij neni [10 të Ligjit nr. 04/L-052] ratifikohen me ligj të votuar nga dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

[...]”

79. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se për qëllimet e inkorporimit të Marrëveshjes në rendin juridik të Kosovës, Qeveria është përgjegjëse të dorëzojë në Kuvend, sipas procedurës së përcaktuar, një projekt të ligjit përkatës, në pajtim me nenin 15 (3) të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.

80. Neni 15 (3) i Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare thotë si në vijim:

“Nëse një ligj ose ndonjë akt tjetër ligjor miratohet me qëllim të zbatimit të një marrëveshjeje ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, Qeveria dorëzon në Kuvend, në bazë të procedurës së paraparë, një projekt të ligjit adekuat ose duhet të miratojë një vendim të Qeverisë ose siguron miratimin e ndonjë akti tjetër ligjor në bazë të kompetencave përkatëse”.

81. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se më 4 dhjetor 2017, Qeveria, në bazë të kompetencave të saj sipas nenit 92 (4) [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës dhe në bazë të Vendimit nr. 02/17 propozoi për miratim në Kuvend Projektligjin për Ratifikimin e Demarkacionit.
82. Gjykata i referohet nenit 60 të Rregullores së punës së Kuvendit i cili rregullon miratimin e këtij lloji të ligjeve, i cili është i ndryshëm nga ligjet e tjera dhe përcakton si vijon:

“[...]

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës, i ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare me ligj, në bazë të nenit 18 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës.

2. Projektligji për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare i përmban tekstin e marrëveshjes ndërkombëtare, arsyet e ratifikimit dhe deklaratën financiare, në rastet kur ka implikime buxhetore.

3. Procedimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare është i veçantë dhe i nënshtrohet vetëm një shqyrtimi.

[...]”

83. Në këtë drejtim, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet formulimit të nenit 60 (3) i Rregullores, i cili parasheh që *“Procedimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare është i veçantë dhe i nënshtrohet vetëm një shqyrtimi.”* Ligjet e tjera të miratuara nga Kuvendi kërkojnë më shumë se një shqyrtim.

Pretendimi për shkelje të nenit 69 (4) të Kushtetutës

84. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të nenit 69 (4) të Kushtetutës, në lidhje me nenin 38 (3) të Rregullores së punës, sepse seanca e jashtëzakonshme ka nevojë për arsyetim se pse një çështje e caktuar është urgjente.
85. Gjykata vëren se neni 69 (4) i Kushtetutës nuk kërkon shprehimisht e as në mënyrë implicite nga aktorët politikë që të ofrojnë justifikim të plotë për të thirrur një mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit. Gjykata është e detyruar të vlerësojë respektimin e procedurës kushtetuese dhe në rastin konkret, Kuvendi ka respektuar dispozitat kushtetuese për miratimin e Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit.
86. Rrjedhimisht, pretendimi për shkeljen e nenit 69 (4) të Kushtetutës është qartazi i pabazuar në bazë kushtetuese.

Pretendimi për shkelje të nenit 18 të Kushtetutës në lidhje me Ligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare nr. 04/L-052

87. Gjykata gjithashtu rikujton që parashtuesit e kërkesës pretendojnë shkelje të nenit 18 të Kushtetutës, sepse Ligji për Marrëveshjet Ndërkombëtare nr. 04/L-052 nuk parasheh që një marrëveshje ndërkombëtare duhet të ratifikohet (në seancë të jashtëzakonshme) si urgjente.
88. Gjykata vëren se neni 18 i Kushtetutës nuk rregullon ritmin e një çështjeje për t'u shqyrtuar dhe votuar nga deputetët e Kuvendit. Nëse një çështje konsiderohet 'urgjente' apo jo, lihet në diskrecionin e aktorëve politikë. (Shih, *mutatis mutandis*, rasti nr. KO118/16, *Slavko Simiq dhe 10 deputetë të tjerë*, Aktvendim për papranueshmëri, i 31 tetorit 2016 dhe rasti nr. KO120/16, *Slavko Simiq dhe 10 deputetë të tjerë*, Aktvendim për papranueshmëri i shkurtit 2017).
89. Gjykata vëren se Ligji për Ratifikimin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare nuk rregullon procedurën për miratimin e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe në veçanti nuk përmend "urgjencën" e miratimit ose "seancën e jashtëzakonshme" nuk është relevant. Kjo është një çështje e prioritetit legjislativ dhe menaxhim i punës së Kuvendit. Kushtetuta rregullon procesin dhe procedurën legjislativ.
90. Gjykata konsideron se pretendimi i ngritur nga parashtuesit e kërkesës nuk bie brenda fushëveprimit të procedurave të rregulluara me Kushtetutë. Nuk mund të pritet që secili ligj që merret me çështje legjislativ specifike të parasheh procedurë të veçantë për miratimin e tij. Në fund të fundit, është organi legjislativ ai që vendosë.
88. Prandaj, Gjykata konkludon se procedura dhe miratimi i Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit është në pajtim me Kushtetutën. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson, në përputhje me parimin e hierarkisë së normave, se ligjet i nënshtrohen Kushtetutës dhe jo anasjelltas.
91. Rezulton se pretendimi i parashtuesve për shkelje të nenit 18 të Kushtetutës është qartazi i pabazuar në bazë kushtetuese.

Pretendimi për shkelje të nenit 69 (3) të Kushtetutës

92. Gjykata më tej rikujton se parashtuesit e kërkesës ankohen se është shkelur neni 69 (3) i Kushtetutës, në lidhje me nenin 51 (3) të Rregullores së punës së Kuvendit, sepse nuk është verifikuar nëse kanë votuar të gjithë deputetët që kanë përbërë kuorumin "Për", "Kundër" ose "Abstenim".
93. Gjykata vlerëson se sipas transkriptit të seancës së jashtëzakonshme plenare të Kuvendit, nëntëdhjetë e një deputetë ishin të pranishëm dhe votuan. Tetëdhjetë (80) deputetë votuan për, njëmbëdhjetë (11) deputetë votuan kundër, pa asnjë abstenim. Ligji për Ratifikimin e Demarkacionit u miratua në tërësi. Kështu, procedura legjislativ u zhvillua në pajtim me nenin 18 (1) të Kushtetutës, i cili trajton ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare.

94. Rrjedh se pretendimi për shkelje të nenit 69 (3) të Kushtetutës është qartazi i pabazuar në bazë kushtetuese.

Pretendimi për shkelje të nenit 18 të Kushtetutës në lidhje me nenin 21 të Rregullores së punës së Kuvendit

94. Gjkata në fund rikujton se parashtuesit e kërkesës pretendojnë shkelje të neneve 18 dhe 80 të Kushtetutës në lidhje me nenin 21 të Rregullores së punës së Kuvendit, sepse deputetëve të larguar u është mohuar e drejta për të shprehur vullnetin e tyre të lirë.
97. Gjkata vëren se ata deputetë u përjashtuan nga seanca e Kuvendit 'për shkak të hedhjes së gazit lotsjellës'. Gjkata konsideron se "hedhja e gazit" nuk hyn në kuadër të kushtetutshmërisë dhe sundimit të ligjit. Sa i përket pohimit se deputetët e larguar faktikisht nuk kishin hedhur ose nuk janë fajtorë për hedhjen e gazit lotsjellës, autoritetet përkatëse duhet që të bëjnë hetimet dhe përfundimet e nevojshme për këtë bazuar në Rregulloren e punës së Kuvendit dhe në legjislacionin tjetër në fuqi. Prandaj, Gjkata shqyrton kushtetutshmërinë e një procedure legjislative dhe përputhjen e saj me dispozitat përkatëse të Kushtetutës.
98. Në dritën e shqyrtimeve të mësipërme, Gjkata vëren se Kuvendi ka ndjekur procedurat e parapara në paragrafin 1 dhe 4 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] dhe paragrafin 1 të nenit 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, nenin 10 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe rregullin 60 të Rregullores së punës së Kuvendit.
99. Rezulton se ky pretendim për shkelje të nenit 18 të Kushtetutës është qartazi i pabazuar në bazë kushtetuese.

Përfundim lidhur me procedurën e ndjekur

100. Prandaj, sa i përket pjesës së kërkesës në lidhje me ankesën procedurale për miratimin e Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit, Gjkata konkludon se procedura e ndjekur për miratimin e Ligjit të kontestuar është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Sa i përket substancës së Ligjit të kontestuar

101. Parashtuesit ankohen në lidhje me standardet e përdorura nga Komisioni për Demarkacion dhe tejkalimin e pretenduar të mandatit të dhënë kushtetues që rezulton në shkelje të Kushtetutës.
102. Në këtë drejtim, Gjkata thekson se *"marrëveshjet ndërkombëtare shërbejnë për plotësimin e një nevoje themelore të shteteve për të rregulluar, me pëlqim, çështjet e shqetësimit të përbashkët, dhe kështu të sjellin stabilitet në marrëdhëniet e tyre reciproke. Pra, marrëveshjet ndërkombëtare janë instrument për të siguruar stabilitet, besueshmëri dhe rend në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe, rrjedhimisht, marrëveshjet gjithmonë kanë qenë burim*

kryesor i marrëdhënieve juridike ndërmjet shteteve” (Gjykata Kushtetuese, rasti nr. KO95/13, *Visar Ymeri dhe 11 deputetë të tjerë*, Aktgjykim i 9 shtatorit 2013, paragrafi 94).

103. Në lidhje me këtë, Gjykata shqyrton nëse është kompetente në bazë të Kushtetutës për të trajtuar këto ankesa. Siç u përmend më lart në analizën krahasimtare, janë disa kushtetuta që i japin kompetenca Gjykatës Kushtetuese për të bërë vlerësimin e pajtueshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën. Për shembull, Shqipëria dhe Bullgaria u japin gjykatave të tyre kushtetuese kompetencë për të bërë vlerësimin e kushtetutshmërisë së një marrëveshjeje ndërkombëtare para ratifikimit të saj, ndërsa Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia dhe Maqedonia janë përcaktuar të mos u japin gjykatave të tyre kushtetuese juridiksion për të vlerësuar marrëveshjet ndërkombëtare. Përveç këtyre, Sllovenia ka përqafuar një sistem të përzier ku, gjatë procedurës së ratifikimit, Gjykata Kushtetuese vlerëson kushtetutshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare nëse shprehimisht kërkohet nga Presidenti, nga Qeveria, apo nga një e treta e deputetëve të Parlamentit (Gjykata Kushtetuese, rasti nr. KO95/13, *Ibidem*, paragrafët 93-101).
104. Kësisoj, analiza krahasimtare zbulon se gjykatat kushtetuese të vendeve të hulumtuara përgjithësisht nuk kanë juridiksion për të vlerësuar kushtetutshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare pas miratimit të ligjit për ratifikim nga Parlamenti. Disa gjykata kushtetuese mund të vlerësojnë kushtetutshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare para ratifikimit të tyre bazuar në një fuqizim të qartë me Kushtetutë.
105. Gjykata konsideron se Ligji për Ratifikimin e Demarkacionit dhe Marrëveshja Ndërkombëtare për Demarkacionin janë dy akte të veçanta ligjore. Secili prej këtyre akteve ndjek një procedurë tjetër ligjore. Sa i përket miratimit të Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit nga ana e Kuvendit, Gjykata vëren se ky Ligj është miratuar me shumicë të kërkuar prej dy të tretave (2/3) dhe vetëm me një lexim, siç kërkohet me Kushtetutë. Prandaj, Gjykata konsideron se miratimi i Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit nga Kuvendi është bërë në përputhje me dispozitat procedurale të Kushtetutës.
106. Përveç kësaj, Gjykata konsideron se qëllimi i ligjit të kontestuar është të përcaktojë karakterin ndërkombëtar të Marrëveshjes për Demarkacionin e Kufijve Shtetëror dhe të inkorporojë Marrëveshjen në sistemin juridik të Republikës së Kosovës dhe ta forcojë shtetësinë e saj.
107. Sa i përket substancës së Marrëveshjes Ndërkombëtare për Demarkacionin e Kufijve Shtetëror, Gjykata vëren se asnjë nen i Kushtetutës nuk parasheh vlerësimin e kushtetutshmërisë së substancës së marrëveshjeve ndërkombëtare nga Gjykata.
108. Në këto rrethana rezulton që, në bazë të Kushtetutës, Gjykata ka juridiksion për të shqyrtuar Ligjin për Ratifikimin e Demarkacionit, por nuk është e autorizuar për të vlerësuar se a është marrëveshja ndërkombëtare, si e tillë, në përputhje me Kushtetutën (Gjykata Kushtetuese, rasti nr. KO95/13, *Ibidem*, paragrafi 100).

109. Prandaj, Gjykata konkludon se nuk është brenda juridiksionit të saj *ratione materiae* të vlerësojë kushtetutshmërinë e Marrëveshjes Ndërkombëtare për Demarkacionin e Kufijve Shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.
110. Si përmbledhje, Gjykata e refuzon kërkesën e parashtruesve për të vlerësuar kushtetutshmërinë e Marrëveshjes Ndërkombëtare për Demarkacionin e Kufijve Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, pasi kjo nuk përbën substancën e Ligjit të kontestuar për Ratifikimin e Demarkacionit. Ligji për Ratifikimin e Demarkacionit është në substancë një mjet për ratifikimin e një marrëveshjeje ndërkombëtare, por substanca e vetë marrëveshjes ndërkombëtare nuk bie në kuadër të vlerësimit të kushtetutshmërisë nga Gjykata.
111. Sa i përket substancës përkatëse të Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit, parashtruesit e kërkesës nuk e shtjellojnë veçmas substancën e tij nga objekti i ratifikimit në fjalë, d.m.th. Marrëveshja Ndërkombëtare e Ratifikimit të Kufijve Shtetëror. Gjykata vëren se substanca e Ligjit të kontestuar është përmbajtja e Ligjit si të tillë dhe përsërit se Marrëveshja Ndërkombëtare nuk përbën substancën e tij. Në bazë të këtij arsyeimi, Gjykata konkludon se substanca e Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit nuk bie në kundërshtim me dispozitat kushtetuese, dhe, prandaj është në përputhje me Kushtetutën.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.5 të Kushtetutës, nenet 20, 42 dhe 43 të Ligjit dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, më 18 prill 2018,

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË njëzëri kërkesën të pranueshme;
- II. TË DEKLAROJË njëzëri se procedura e ndjekur për miratimin e Ligjit nr. 06/L-060 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Demarkacionin e Kufirit Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi është në pajtim me Kushtetutën;
- III. TË DEKLAROJË njëzëri se Ligji nr. 06/L-060 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Demarkacionin e Kufirit Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi nuk është në kundërshtim me Kushtetutën;
- IV. TA REFUZOJË njëzëri kërkesën e parashtruesve për të shqyrtuar Marrëveshjen Ndërkombëtare për Demarkacionin e Kufirit Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi pasi që kërkesa nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën dhe kështu jashtë fushëveprimit të juridiksionit të Gjykatës;
- V. TË DEKLAROJË se në pajtim me nenin 43 të Ligjit për Gjykatën, Ligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për Demarkacionin e Kufirit Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, do t'i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje;
- VI. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim parashtruesve të kërkesës, Presidentit të Republikës së Kosovës, Kryetarit të Kuvendit të Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës;
- VI. TA PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;
- VII. TË DEKLAROJË se ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtarja raportuese



Snezhana Botusharova



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi